

LIGJI NR. 08/L-057

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT 04/ L-089
PËR DEMINIM HUMANITAR**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-089
PËR DEMINIM HUMANITAR**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky Ligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-89 për deminim humanitar (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 6/11 prill 2012).

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky ligj dhe ligji bazik, zbatohen nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës për veprimtaritë që kanë të bëjnë me deminimin humanitar.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. **Ligj bazik** – nënkupton Ligjin Nr. 04/L-89 për deminim humanitar.
2. Shprehjet e tjera të përdorura në këtë ligj kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin bazik.

Neni 4

1. Përkufizimet në nën paragrafin 1.2 dhe 1.3 të nenit 3 të ligjit bazik, ndryshohen dhe riformulohen si në vijim:

1.2. **MM**- Ministria e Mbrojtjes;

1.3. **QKD** - Qendra Koordinuese për Deminim në kuadër të MM-së.

Neni 5

Neni 4 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

**Neni 4
Aktivitetet e deminimit humanitar**

1. Aktivitetet e deminimit humanitar janë:

1.1. pastrimi i fushave të minuara dhe demolimi i MEP”;

1.2. demolimi dhe eliminimi i ME”;

1.3. koordinimi i përdorimit të eksplozivëve për operacionet e deminimit humanitar dhe të EMSH-së.

2. Koordinimi i përdorimit të eksplozivëve sipas nën paragrafit 1.3 të këtij neni do të rregullohet me rregullore të veçantë të nxjerr nga Ministri i Mbrojtjes.

Neni 6

Neni 6 i ligjit bazik, pas nënparagrafit 2.9 shtohen nënparagrafët 2.10, 2.11 dhe 2.12 me tekstin si vijon:

2.10. “autorizon demolimin e ME”;

2.11. “bashkëpunon me autoritet vendore dhe ndërkombëtare për operacionet e deminimit humanitar”;

2.12. “kryen vëzhgimet në teren në zonat e rrezikshme të raportuar për analizimin e tyre dhe caktimin e prioritetëve për pastrim”.

Neni 7

Neni 8, paragrafi 3 i ligjit bazik, fjalet “Ministri i FSK-së”, zëvendësohen me fjalët “Ministri i Mbrojtjes”.

Neni 8

Afat për nxjerrjen e akteve nënligjore

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji nxirren ose ndryshohen në afat prej gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-057

21 janar 2022

Shpallur me dekretin Nr. DL-58/2022, datë 04.02.2022 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu